**UDHËZIM**
**Nr.35, datë 7.10.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 "PËR AKCIZAT", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 "Për akcizat", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2.12. zëvendësohet me pikën 2.12, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"2.12. Importuesit e "maltos", "granulatës" (të kreut 3901 deri 3904 të NKM) dhe "pipetës" (të kreut 3923 të NKM), që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize, subjekte të prodhimit të birrës dhe produkteve plastike, duhet të bëjnë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë autorizim për importimin e maltos, granulatës, pipetës, për qëllime tregtie. Autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jepet për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë përsëritjeje. Çdo subjekt që do të bëjë kërkesë për autorizim si importues i maltos, granulatës, pipetës, për qëllime tregtie, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë më shumë se 3 vjet i regjistruar në organet tatimore si person i tatueshëm i TVSH-së.

b) Të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vet ekonomike.

c) Të mos ketë detyrime tatimore dhe doganore të pashlyera.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo autorizim të lëshuar për tatimpaguesit si importues të maltos, pipetës dhe granulatës. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zhdoganimi i pipetës dhe granulatës bëhet me kilogramë.

Importuesi i autorizuar, për çdo rast të importimit të maltos, pipetës dhe granulatës, duhet të depozitojë si garanci përpara zhdoganimit, në një llogari bankare, 120 lekë për kg malto të importuar dhe 100 lekë për kilogramë granulatë, pipetë, garanci (zhdoganimi për granulatën dhe pipetën do të bëhet në kilogramë), e cila do t'i kthehet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të shitjes së maltos, granulatës dhe pipetës, te tatimpaguesit e autorizuar si prodhues birre apo te tatimpaguesit prodhues të produkteve plastike.

Në rastet kur një tregtari të autorizuar për importimin e maltos, granulatës ose pipetës, i gjenden sasi të maltos, granulatës ose pipetës të padokumentuara ose vërtetohen shitje tek persona të paautorizuar si prodhues birre dhe/ose prodhues produktesh plastike, për këto sasi ai detyrohet të paguajë 120 lekë për kg malto tatim dhe 100 lekë për kg granulatë, pipeta tatim dhe i hiqet e drejta e ushtrimit të këtij aktiviteti duke i tërhequr autorizimin si importues malto, gralulate ose pipete, për një periudhë 2-vjeçare. Organi tatimor ka të drejtë të mbajë garancinë e depozituar për kompensimin e dëmit ekonomik. Nëse personi nuk ka garanci ose ajo nuk është e mjaftueshme për përballimin e dëmit ekonomik, tatimpaguesi paguan shumën totale ose pjesën që nuk mbulohet nga garancia, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit nga organi tatimor. Në të kundërt organi tatimor zbaton procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.".

2. Pika 29 zëvendësohet me pikën 29 me përmbajtje si më poshtë vijon:

"29. Proceset e miratuara nën regjimin e rimbursimit të akcizës

29.1 Proceset e miratuara të përcaktuara në nenin 19(2)(a) janë:

a) prodhimi i produkteve të pranuara mjekësore të miratuara nga organi tatimor dhe që u nënshtrohen procedurave të pikës 30 më poshtë;

b) prodhimi i uthullës që u nënshtrohet procedurave në pikën 31 më poshtë;

c) prodhimi për tregtim i mallrave ushqimore duke përdorur pije alkoolike;

ç) prodhimi i alkoolit të denatyruar që u nënshtrohet procedurave të pikës 32 dhe 33 më poshtë;

d) Prodhimi i mallrave jo të tatueshme me akcizë nga lëndë të para për të cilat është paguar akcizë.

29.2 Akciza e paguar mbi mallrat të cilat janë përdorur në proceset e miratuara më lart jashtë magazinës tatimore mund të bëhet objekt i një kërkese për rimbursim.

29.3 Sipas dispozitave të kësaj pjese, kur një person i vërteton organit tatimor që:

- çdo sasi alkooli e tatueshme, për të cilën është paguar akcizë, është përdorur në një proces të miratuar në pikën 29.1 më lart, ai person ka të drejtë të bëjë kërkesë në organin tatimor për rimbursimin e akcizës së paguar mbi mallrat përkatëse të akcizës të përdorura në prodhimin e atij produkti.

29.4 Rimbursimi i akcizës, në lidhje me ndonjë sasi alkooli, nuk duhet bërë përveçse ndaj një personi, i cili:

- është personi që ka përdorur alkoolin apo pijen alkoolike në një proces të miratuar të specifikuar në paragrafin 29.1 më lart dhe kryen një biznes si furnizues produktesh të renditura në paragrafin 29.1 më lart, të cilat nxirren apo prodhohen për qëllimet e atij biznesi.

29.5 Çdo person që blen mallra akcize që do të përdoren në një proces të miratuar, duhet të sigurohet që fatura të përfshijë:

a) një numër serial vijues;

b) sasinë dhe llojin e mallrave të blera të akcizës;

c) detyrimin e akcizës mbi ngarkesën.

29.6 Rimbursimi do të bëhet vetëm kur mund të verifikohet evidenca e përdorimit të mallrave të akcizës në procesin e miratuar dhe të jetë paguar akciza që kërkohet nga rimbursimi. Çdo person që dorëzon një kërkesë për rimbursim të tatimit të akcizës së paguar mbi mallrat që janë përdorur në një proces të miratuar, duhet të mbajë të dhënat e mëposhtme (përveç të dhënave të zakonshme tregtare) dhe t'i dorëzojë ato sa herë që kërkohen nga organi tatimor:

a) regjistrimet e alkoolit të marrë dhe të përdorur;

b) faturat që tregojnë shumën e akcizës së paguar për mallrat.

29.7 Pas marrjes së kërkesës për rimbursim, së bashku me dokumentet mbështetëse, Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse, nëse bindet, do të marrë masa për miratimin e rimbursimit, që do të paguhet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përveçse në rastet kur kërkesa i nënshtrohet një investigimi të mëtejshëm për të verifikuar vërtetësinë e saj.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**